

2023

UDHËZUES

**PËR DETAJIMIN E PROCEDURAVE PËR TË PËRFITUAR NGA PROGRAMI I
ZHVILLIMIT TË OBJEKTEVE TË REJA DHE PROGRAMI I RINDËRTIMIT**

Bashkia Tiranë

Qershor 2020

Table of Contents

| | |
|--|---|
| <u>1. HYRJE</u> | 3 |
| <u>2. MISIONI</u> | 3 |
| <u>3. BAZA LIGJORE</u> | 4 |
| <u>4. PËRKUFIZIME</u> | 5 |
| <u>V. PËRFITUESIT POTENCIAL DHE SUBJEKTET PËRJASHTUESE</u> | 6 |
| <u>6. PROGRAMET E PROCESIT TË RINDËRTIMIT</u> | 7 |
| <u>7. SHTRIRJA GJEOGRAFIKE</u> | 9 |
| <u>8.ZBATIMI I PROGRAMIT Të RINDËRTIMIT</u> | 9 |

I. HYRJE

Bashkia Tiranë në zbatim të kompetencave të dhëna nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi e angazhuar për të kryer procedurat për zbatimin e programeve dhe procesit të rindërtimit me qëllim mbarëvajtjen e procesit të Rindërtimit në nivel lokal, dhe rimëkëmbjen nga gjendja e fatkeqësisë natyrore, e shkaktuar nga tërmeti i datës 26.11.2019, harton këtë udhëzues operacional.

Ky udhëzues do të shërbejë për vënien në zbatim të aktit normativ dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave të miratuara në zbatim të tij, me qëllim unifikimin e rregullave dhe procedurave për aplikimin pranë Njësi Administrative/Lagjeve dhe përfitimin nga programet e procesit të rindërtimit.

Procesi i rindërtimit është konceptuar si një proces i integruar i përbërë nga disa programe, në funksion të përmirësimit të kushteve të jetesës dhe të shëndetit.

Në nenin 18 të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, parashikohen programet që përfshin procesi i rindërtimit në funksion të përmirësimit të kushteve të jetesës dhe të shëndetit pas shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, si më poshtë:

1. Programi i zhvillimit të objekteve të reja që përbëhet nga këto nënprograme:

- a) Zhvillimi i objekteve të reja dhe i zonave të reja për zhvillim, përfshirë infrastrukturën publike përkatëse, si dhe rikonstruksionin e ndërtesave ekzistuese të dëmtuara dhe të infrastrukturës publike nga autoritetet shtetërore;
- b) Zhvillimi i objekteve të reja dhe zonave të reja për zhvillim, përfshirë infrastrukturën publike përkatëse, si dhe rikonstruksionin e ndërtesave ekzistuese të dëmtuara dhe të infrastrukturës publike, nga donatorët;
- c) Rindërtimi i ndërtesave të shembura nga fatkeqësia natyrore në të njëjtin truall;
- ç) Programi i bashkëpunimit për ndërtime në bashkëpunim me sektorin privat.

2. Programi i krijimit të fondit të banesave përbëhet nga:

- a) Programi i blerjes së banesave të reja në treg të lirë;
- b) Programi i banesave të dhuruara nga subjektet private.

Në zbatim të procesit të rindërtimit lind e nevojshme përcaktimi i një procedure të detajuar në lidhje me hapat që duhet të ndiqen nga secila strukturë e Bashkisë Tiranë, e krijuar për këtë qëllim, në funksion të mbarëvajtjes normale të punës dhe përmbylljes me sukses të këtij procesi.

II. MISIONI

Programi i Rindërtimit ka për qëllim rimëkëmbjen nga gjendja e fatkeqësisë natyrore për atë sa është e mundur, garantimin e kthimit në kushte optimale jetese dhe funksionimin e komuniteteve të prekura nga fatkeqësitë natyrore, si dhe forcimin e aftësisë së këtyre komuniteteve për t'i bërë ballë gjendjeve të fatkeqësive natyrore në të ardhmen.

III. BAZA LIGJORE

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", i cili ka për qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe realizimin e mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile. Pika 23, e nenit 3, të këtij ligji e ka përkufizuar mbrojtjen civile si "tërësinë e masave të marra për parashikimin, parandalimin, lehtësimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit". Bazuar në nenin 30, të ligjit nr. 45/2019, sanksionohet, ndër të tjera, se institucionet vendore sigurojnë, administrojnë dhe përditësojnë të dhënat e nevojshme për shtetasit dhe për subjektet private, të mundshme për t'u planifikuar dhe angazhuar në parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive.

Duke u mbështetur në nenin 101, të Kushtetutës, ku parashikohet se Këshilli i Ministrave, në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme, është miratuar Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, i Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019.

Ky akt rregullon funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse.

Në zbatim të këtij Akti Normativ, Këshilli i Ministrave ka miratuar një sërë vendimesh të tjera që rregullojnë përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, procedurat e aplikimit dhe përfitimit nga programet e procesit të rindërtimit etj, ku më kryesoret mund të përmendim:

Vendimin nr. 904, datë 24.12.2019, i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit";

Vendimin nr. 5, datë 6.1.2020, i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model";

Vendimin nr. 8, datë 6.1.2020, i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje";

Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr.21 datë 17.03.2020 "Miratimin e sistemit të pikëzimit për subjektet përfitues nga programi i zhvillimit të objekteve të reja dhe programi i granteve të rindërtimit në kuadër të zbatimit të procesit të rindërtimit ;

Urdhri i Kryetarit të Bashkisë nr. 4639, datë 29.01.2020, " Për caktimin e njësive Administrative/ lagje si strukturat përgjegjëse për zbatimin e fazës së parë të aplikimit, për përfitimin nga programet e procesit të rindërtimit";

Urdhëri i Kryetarit të Bashkisë, nr.1408, dat 25.03.2020 “ Për krijimin e Komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve përfitues nga programi i grantit të rindërtimit’.

IV. PËRKUFIZIME

Për efekt të zbatimit të këtij programi, këto terma kanë kuptimin si më poshtë:

1. **“Banesë”**, një ndërtesë ose një njësi banimi brenda një ndërtese që përbëhet nga bashkësia e mjediseve ose mjedisi i vetëm që ka hyrje të pavarur dhe dalje në kat, oborr, tarracë ose rrugë e destinuar për banim.
2. **“Donacion”**, akti i ofrimit të mjeteve financiare ose i kontributeve në natyrë në mënyrë vullnetare nga donatorët.
3. **“Donatorë”**, janë individët, personat fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, qeveritë e shteteve të huaja, institucionet bankare dhe institucionet financiare jobankare, organizatat jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, organizmat ndërkombëtarë, që kontribuojnë në mjete financiare ose në natyrë, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas parashikimeve të këtij akti.
4. **“Familje”**, konsiderohen individët që rezultojnë në përbërjen familjare sipas të dhënave në regjistrin e gjendjes civile përkatëse.
5. **“Fatkeqësi natyrore” dhe “Fatkeqësi tjetër”** kanë të njëjtin kuptim sipas ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”. Kur në këtë akt përdoren fjalët fatkeqësi natyrore, parashikimet përkatëse zbatohen njësoj dhe për fatkeqësinë tjetër.
6. **“Gjendja e fatkeqësisë natyrore”**, është gjendja e vendosur nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile, në një pjesë ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për parandalimin ose mënjanimin e pasojave të një fatkeqësie natyrore ose të fatkeqësive të tjera.
7. **“Marrëveshje kuadër”**, marrëveshja që lidhet me operatorët ekonomikë, në përfundim të fazës së parë kualifikuese, për secilën procedurë prokurimi publik të procesit të rindërtimit, sipas parashikimeve të këtij akti.
8. **“Njësi zbatuese”**, një ose disa organe publike të ngarkuara nga Këshilli i Ministrave për administrimin e fondeve të transferuara nga fondi i rindërtimit, si dhe për kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në këtë ligj.
9. **“Prokurimi publik për rindërtimin”**, procesi i përshpejtuar i prokurimit që zbatojnë autoritetet kontraktore për përzgjedhjen e fituesve për kontratat publike për mallra, punë dhe shërbime, në kuadër të zbatimit të procesit të rindërtimit, në përputhje me parashikimet e këtij akti dhe të ligjit për prokurimin publik, për aq sa nuk bie në kundërshtim me parashikimet e këtij akti.
10. **“Plan i detyruar vendor”**, dokument planifikimi që hartojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe autoritetet përgjegjëse, sipas rastit, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore dhe, kur çmohet e nevojshme, për të garantuar sigurinë e jetës dhe të shëndetit, që përcakton kushtet për zhvillim të detyruar, si dhe zhvillimin e zonave të reja.
11. **“Prishje e detyruar”**, procesi i shembjes së një ndërtese apo disa ndërtesave, në pronësi private apo publike, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, që përbëjnë rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe që nuk mund të riparohen, siç vërtetohet nga aktekspertiza e thelluar.
13. **“Ndërtesë e dëmtuar”**, çdo ndërtesë, në pronësi publike apo private, e dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, që përbën rrezik për jetën e shëndetin e njerëzve dhe që nuk mund të riparohet.

14. "Zonë e dëmtuar", territori që përfshin një ose disa ndërtesa, infrastruktura publike apo edhe infrastrukturë kritike të dëmtuar.

15. "Aktekspertizë e thelluar", është akti që lëshon çdo person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare, i pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, nga ndërtesa apo grupi i ndërtesave të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, si dhe ku rekomandohen masat që duhen marrë sipas parashikimeve në këtë ligj.

16. "Infrastrukturë publike", janë ndërtesat në pronësi publike, si dhe rrugët, sheshet, parqet apo hapësira të ngjashme publike, të ndryshme nga infrastruktura kritike.

17. "Infrastrukturë kritike", janë strukturat fizike, rrjetet dhe pasuritë e tjera, të cilat janë të domosdoshme për funksionimin ekonomik e social të shoqërisë ose të komunitetit, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile".

18. "Zhvillim i detyruar", e drejta e autoritetit përgjegjës për të vendosur prishjen e ndërtesave dhe zhvillimin e territorit ku ndodhen ndërtesa apo një grup ndërtesash, në pronësi publike apo private, si rezultat i dëmtimit të tyre nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore dhe që rrezikon jetën e shëndetin e banorëve, si dhe për zhvillimin e zonës së re në përputhje me planin e detyruar vendor,

sipas parashikimeve të këtij akti.

19. "Zonë e re për zhvillim", territori që përcaktohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shpallet me vendim të Këshillit të Ministrave, si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas

kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë ligj.

V. PËRFITUESIT POTENCIAL DHE SUBJEKTET PËRJASHTUESE

SUBJEKTET PËRFITUESE

Referuar Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", në nenin 5 të tij dhe vendimit nr.904/2019 parashikohen subjektet përfituese dhe jopërfituese si më poshtë vijon:

1.Subjekte përfituese janë individët dhe familjet, që kanë humbur një ose më shumë anëtarë të familjes dhe/ose kanë pësuar dëme në banesat e tyre dhe kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe institucionet publike që kanë pësuar dëme në ndërtesat apo infrastrukturën publike në pronësi apo në administrim të tyre, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore.

2.Familjet, që kanë humbur banesat si pasojë e shembjeve të ndërtesave (pallateve), përfitojnë nga programi i zhvillimit të zonave të reja ose programi i rindërtimit të godinave në të njëjtin truall ose programi i fondit të banesave. Struktura e njësisë së banimit (apartament), që i kalohet në pronësi përfituesve në ndërtesat e reja, llogaritet sipas tabelës A, që i bashkëlidhet vendimit 904/2019 dhe është pjesë përbërëse e tij. Strukturë njësie në kuptim të kësaj pike është sipërfaqja e shkelshme e banesës në numër dhomash, kuzhinë, korridor, banjë e ambiente ndihmëse.

3. Familjet në qytet, që kanë humbur shtëpitë individuale si pasojë e shembjes, përfitojnë nga programi i zhvillimit të zonave të reja ose programi i granteve të rindërtimit ose programi i fondit të banesave.

4. Familjet në fshat, që kanë humbur shtëpitë individuale jashtë ose brenda zonës së urbanizuar të territorit rural, si pasojë e shembjes, përfitojnë nga programi i zhvillimit të zonave të reja ose programi i granteve të rindërtimit. Rregullat e përfitimit sipas në pikës 20.2 që parashikohen në vendimin 904/2019, zbatohen njësoj, për aq sa është e mundur, dhe për përfituesit që përcaktohen në këtë pikë.

5. Subjektet që kanë pësuar dëme në ndërtesa, jashtë territorit ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë, në rastet kur provohet se dëmet janë pasojë e fatkeqësisë natyrore përfitojnë kompensimin e dëmeve sipas parashikimeve të këtij akti.

SUBJEKTET JO-PËRFITUESE

1. Nuk është subjekt përfitues individ i ose familja që ka në pronësi ose posedim të ligjshëm, më shumë se një banesë, në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, pavarësisht nëse banesa që është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore ka qenë vendbanimi i zakonshëm. Në rast se të gjitha banesat në pronësi ose në posedim janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, individ i ose familja përfiton, sipas parashikimeve të këtij akti, vetëm për banesën që në datën e fatkeqësisë natyrore përdorej si vendbanim i zakonshëm. Nëse pas përfitimit, sipas kësaj pike, banesa ose banesat e tjera të familjes përfshihen në planin e detyruar vendor, përfitimi i sipërfaqeve në ndërtimet e reja do të kryhet sipas parashikimeve të këtij akti.

2. Nuk janë subjekte përfituese subjektet e së drejtës tregtare në fushën e ndërtimit për ndërtesat ose njësitë brenda një ndërtese në pronësi të tyre, që janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, kur dëmi ka ardhur si rrjedhojë e gabimeve në projektimin apo ndërtimin e ndërtesës kryer prej vetë subjektit ndërtues që është njëkohësisht dhe pronar i objektit, përveç rastit kur zbatohet zhvillimi i detyruar vendor sipas parashikimeve të këtij akti.

3. Subjekti përfitues nuk mund të përfitojë në të njëjtën kohë nga më shumë se një program në procesin e rindërtimit për qëllime strehimi, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në aktet ligjore. Subjektet të cilat nuk përfitojnë nga një program i caktuar, do kenë mundësi për të kaluar në një program tjetër të procesit të rindërtimit, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave.

VI. PROGRAMET E PROCESIT TË RINDËRTIMIT

6.1. Programi i zhvillimit të objekteve të reja

a) Zhvillimi i objekteve të reja dhe i zonave të reja për zhvillim, përfshirë infrastrukturën publike përkatëse, si dhe rikonstruksioni i ndërtesave ekzistuese të dëmtuara dhe të infrastrukturës publike nga autoritetet shtetërore;

b) Zhvillimi i objekteve të reja dhe zonave të reja për zhvillim, përfshirë infrastrukturën publike përkatëse, si dhe rikonstruksionin e ndërtesave ekzistuese të dëmtuara dhe të infrastrukturës publike, nga autoritetet shtetërore nga donatorët;

c) Rindërtimi i ndërtesave të shembura nga fatkeqësia natyrore në të njëjtin truall;

ç) Programi i bashkëpunimit për ndërtime në bashkëpunim me sektorin privat.

**Ndërtimet pa leje në zonat e reja për zhvillim dhe/ose në zonat e planifikuara për ndërtim sipas Aktit Normativ, përjashtohen nga procedurat e legalizimit dhe subjektet poseduese të*

ndërtimeve pa leje trajtohen sipas parashikimeve të aktit Nr. 9 datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", në përputhje me parimin e strehimit të përshtatshëm. Për poseduesit e ndërtimeve pa leje, regjistrimi i njërive të banimit kryhet në emër të aplikuesit për legalizim të ndërtimit pa leje ose, në rast të mungesës së aplikimit, në emër të të gjithë familjarëve madhorë në momentin e regjistrimit të kontratës së dhurimit. Rregulla më të detajuara në lidhje me përfitimin nga këto subjekte janë përcaktuar në vendimin nr. 8, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje".

6.2. Programi i krijimit të fondit të banesave

- a) Programi i blerjes së banesave të reja në treg të lirë;
- b) Programi i banesave të dhuruara nga subjektet private

Enti Kombëtar i Banesave ose njësitë e vetëqeverisjes vendore blejnë banesa në tregun e lirë, në rast se vlera e banesës në treg është më e ulët ose e barabartë me koston e ndërtimit. Banesa mund të blihet nga tregu, përjashtimisht, kur vlera e banesës në treg është më e lartë se kostoja e ndërtimit, vetëm kur:

- a) vërtetohen kushte emergjente për strehimin e subjekteve përfituese, sipas Aktit Normativ; ose
- b) autoritetet shtetërore janë në pamundësi për të plotësuar nevojat për strehim të subjekteve përfituese, sipas parashikimeve të Aktit Normativ.

Për blerjen e banesave të mobiluara nuk zbatohet legjislacioni për prokurimin publik. Autoritetet përgjegjëse vlerësojnë për blerjet çmimet mesatare të tregut të lirë, duke përzgjedhur në bazë të çmimit të favorshëm dhe të cilësisë së kërkuar, në ftesën për ofertë që i dërgojnë subjekteve tregtare të tregut të lirë. Autoritetet përgjegjëse marrin masa për të organizuar procedura transparente për blerjet që parashikohen në Aktin Normativ. Banesat e blera duhet të jenë të regjistruara në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme, të lira nga çdo barrë dhe hipotekë.

** Kur lista e përfituesve me përparësi shteron dhe kanë mbetur banesa të lira, shpërndarja e tyre kalon sipas renditjes së përfituesve, kryer nga autoritetet përgjegjëse, sipas parashikimeve të Aktit Normativ. Në rast se pas plotësimit të nevojave për strehim, ka njësi banimi të lira, ato administrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose Enti Kombëtar i Banesave, me qëllim plotësimin e nevojave për strehim, në përputhje me parashikimet e ligjit për strehimin social.*

Sipas nenit 18, pika 8, të Aktit Normativ, Kriteret e përparësisë për renditjen e përfituesve për secilin nga programet janë:

- a) Familjet që kanë humbur familjarët nga fatkeqësia natyrore;
- b) Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;
- c) Familjet që kanë në përbërje personat me aftësi të kufizuara;

- ç) Të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit;
- d) Familjet në skemën e ndihmës ekonomike;
- dh) Të rënë në krye të detyrës.

1. Familjet, që kanë humbur banesat si pasojë e shembjeve të ndërtesave (pallateve), përfitojnë nga programi i zhvillimit të zonave të reja ose programi i rindërtimit të godinave në të njëjtin truall ose programi i fondit të banesave. Struktura e njësisë së banimit (apartament), që i kalohet në pronësi përfituesve në ndërtesat e reja, llogaritet sipas tabelës "A"

Strukturë njësie në kuptim të kësaj pike është sipërfaqja e shkelshme e banesës në numër dhomash, kuzhinë, korridor, banjë e ambiente ndihmëse.

2. Familjet në qytet, që kanë humbur shtëpitë individuale si pasojë e shembjes, përfitojnë nga programi i zhvillimit të zonave të reja ose programi i granteve të rindërtimit ose programi i fondit të banesave si më poshtë:

a) Sipërfaqja e banesës që i kalohet në pronësi përfituesve, në ndërtesat e realizuara në kuadër të programit të zhvillimit të zonave të reja ose në banesat e programit të fondit të banesave, llogaritet sipas tabelës "A".

- Përfituesit ruajnë të drejtën e pronësisë për truallin e shtëpisë individuale, përveç rastit kur për nevoja të zhvillimit të programeve të rindërtimit prona truall shpronësohet ose kompensohet sipas parashikimeve të aktit normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore".

Tabela "A"

| Përbërja familjare | Struktura apartamentit | Sipërfaqja në metër katrorë (m ²) |
|----------------------|------------------------|---|
| Deri në 2 anëtarë | 1+1 | 45m ² deri në 60 m ² |
| 2 deri në 4 anëtarë | 2+1 | 75 m ² deri në 80 m ² |
| 5 e më shumë anëtarë | 3+1 | 90 m ² deri në 100 m ² |

b) Kur zona e re për zhvillim do të realizohet me shtëpi banimi individuale, familjet përfitojnë në pronësi shtëpi individuale banimi me sipërfaqe ndërtimi që llogariten sipas tabelës B.

- Në këto raste, përfituesit ruajnë të drejtën e pronësisë për sipërfaqen e truallit që rezulton si diferencë e truallit të shtëpisë individuale të shembur me truallin e shtëpisë individuale banimi të re që përfitojnë, nëse ka, përveç rastit kur, për nevoja të zhvillimit të programeve të rindërtimit, kjo sipërfaqe trualli shpronësohet ose kompensohet sipas parashikimeve të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore".

- Në kontratën përkatëse të kalimit të pronësisë për shtëpinë individuale të re sipas kësaj pike, parashikohet dhe heqja dorë e përfituesit nga e drejta e pronësisë në favor të shtetit prej sipërfaqes së truallit të shtëpisë individuale të shembur, e barabartë me truallin e shtëpisë së re individuale.

Tabela "B"

| Përbërja familjare | Sipërfaqja në metër katrorë (m²) |
|---------------------------|--|
| Deri në 2 anëtarë | 60 m ² deri në 70 m ² |
| 2 deri në 4 anëtarë | 70 m ² deri në 80 m ² |
| 5 e më shumë anëtarë | Jo më pak se 90 m ² |

- Rregullat e përfitimit që parashikohen në pikën 2 shkronja a dhe shkronja b më lart, zbatohen njësoj, për aq sa është e mundur për Familjet në fshat, që kanë humbur shtëpitë individuale si pasojë e shembjes nga fatkeqësia natyrore.

e) Kur njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet shtetërore përgjegjëse vendosin që të trajtojnë përfituesin me grant për rindërtimin e shtëpisë individuale zbatojnë kushtet dhe rregullat sipas parashikimeve të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore"

VIII. SHTIRRJA GJEOGRAFIKE

Programi synon të përfshijë dhe mbështesë të gjithë Familjet në qytet apo fshat, që kanë humbur shtëpitë individuale si pasojë e shembjes nga fatkeqësia natyrore si dhe kanë vendbanim në territorin e Bashkisë Tiranë.

IX. ZBATIMI I PROGRAMIT TË RINDËRTIMIT

- Zbatimi i programit të rindërtimit, i financuar me fondet e buxhetit të shtetit dhe/ose buxheti i Bashkisë Tiranë udhëhiqet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, e cila koordinon punën me Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile dhe/ose me struktura të tjera, të cilat do të bashkërendojnë punën për zbatimin e këtij procesi.
- Strukturat e tjera të përfshirë në procesin e nënprogramit të grantit të rikonstruksionit janë:
- Njësitë Administrative dhe Lagjet;
- Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale;
- Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit
- Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar;
- Sekretariati Teknik;

- Komisioni i Posaçëm;
- Zëvendëskryetari i Bashkisë;
- Kryetari i Bashkisë;
- Këshilli Bashkiak.

Referuar pikës 3 të vendimit nr. 904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", aplikimi për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit sipas parashikimeve të këtij vendimi bëhet me dy faza.

- Në fazën e parë aplikantët paraqesin kërkesën e tyre sëbashku me dokumentat e kërkuara për të përfituar nga programi i rindërtimit.
- Në fazën e dytë të aplikimit përfshihen vetëm ata/o individë/familje që janë përzgjedhur për t'u trajtuar nga programet e rindërtimit.

I. Faza e parë.

- Të gjithë individët dhe familjet, që kanë pësuar dëme në banesat e tyre dhe kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, paraqesin kërkesën e tyre për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit, pranë Njësisë Administrative/Lagjeve përkatëse.
- Çdo njësi Administrative/Lagje, hap një ose më shumë sportele të dedikuara vetëm për aplikuesit e programeve të procesit të rindërtimit. Aplikantët, në zbatim të VKM nr. 904/2019, plotësojnë formularin, deklaratën e Vërtetësisë së informacionit paraprak (shtojca B sipas VKM Nr. 904/2019), bashkëlidhur materialit, vërtetimi që konfirmon regjistrimin e kërkesës, objektin e saj, datën dhe listën e dokumentave të bashkëlidhur. (shtojca C, sipas VKM Nr. 904/2019), deklaratën për dhënien e pëlqimit për lejen për marrjen e dokumentacionit për fazën e dytë (shtojca Ç, sipas VKM Nr. 904), pranë njësisë administrative/lagjeve përkatëse. Njësitë administrative/lagjet regjistrojnë aplikimet në një sistem elektronik, i cili jep mundësinë e përpunimit të të dhënave të mëposhtëme:

1. Informacion i reflektuar në shtojcën A, bashkëlidhur materialit.

- a) emrin, atësinë, mbiemrin;
 - b) numrin e aplikimit;
 - c) datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit;
 - ç) objektin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për të përfituar nga programi i grantit të rindërtimit dhe tipi i projektit model të zgjedhur ose projektin e kryer vetë nga kërkuesi/aplikanti.
 - d) adresën e kërkuesit;
2. Çertifikata familjare (Përbërjen familjare në momentin e aplikimit).
 3. Karta e id (fotokopje) e aplikuesit.
 4. Aktin e konstatimit/Aktekspertizën e thelluar shoqëruar me prenventiv, të lëshuar nga Instituti i Ndërtimit ose grupet përkatëse të inspektimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore ose çdo person, fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare, i pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës

nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, në të cilin vërtetohen dëmet që ka pësuar ndërtesa e shpallur si e pabanueshme;

5.Çdo lloj dokumentacioni që provon të drejtat e pronësisë mbi objektin e dëmtuar;

*Referuar listës së hartuar nga AKSHH, në dokumentet që provojnë pronësinë përfshihen:

- Certifikatë pronësie e shoqëruar me kartelën e pasurisë së rifreskuar.
- Vërtetim hipotekor
- Kartelë e pasurisë së paluajtshme
- Vërtetim legalizimi
- Aplikim sipas VKM 442 për ndërtimet para Gushtit të vitit 1991
- Listë Trojesh
- Leje legalizimi
- Leje ndërtimi
- Kontratë privatizimi
- Kontratë shitje
- Kontratë porosie
- Leje ndërtimi (Komiteti Ekzekutiv)
- Vërtetim fakti (Gjykata e faktit vendimet deri më vitin 1994)
- Vërtetim i Komisionit për kthim dhe kompensim
- Vendim Gjyqësor
- Vërtetim Karabine (të shoqërohet me Leje ndërtimi)
- Kontratë Shkëmbimi
- Kontratë Sipërmarrje
- Akt-Marrëveshje
- Vërtetimin e lëshuar nga kryesia apo kryetari i fshatit, i cili vërteton ekzistencën banesës së dëmtuar dhe se aplikuesi ka pasur aty vendbanimin e tij në momentin e rënies së tërmetit të datës 26 nëntor 2019.

Dokumentacioni i paraqitur sipas pikës 5 më sipër duhet të jetë origjinal ose i njëzuar me origjinalin nga noteri publik.

II. Faza e dytë e aplikimit

- Pas plotësimit të formularëve dhe dokumentacionit si më lart, Njësitë Administrative/Lagjet përkatëse i përcjellin ato në Bashkinë Tiranë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale (Drejtoria e Rindërtimit të Shërbimeve Sociale), e cila realizon procesin e seleksionimit të formularëve në varësi të statusit të shkallës së

dëmtimeve të pasqyruara në formularin e aplikimit dhe programit të zgjedhur nga aplikuesi (DS4/DS5).

- Në rast se gjatë shqyrtimit paraprak, nga Drejtoria e Rindërtimit të Shërbimeve Sociale konstatohet mangësi në dokumentacionin e kërkuar, e ridërgon dosjen për plotësim/saktësim pranë njësive administrative/lagjeve përkatëse, të cilët brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e marrjes në dorëzim të tyre, duhet të njoftojnë aplikantët për plotësimin e të dhënave.
- Njësitë administrative/lagjet brenda 5 (pesë) ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës së DRSHS për kthimin e dosjes, njofton aplikantin për plotësimin apo korigjimin e dokumentacionit të kërkuar. Aplikanti brenda një afati prej 7 ditë duhet të plotësojnë dhe të dorëzoj dokumentacionin e kërkuar pranë njësive administrative/lagjeve. Nëse në përfundim të këtij afati, aplikuesi nuk depoziton informacionin e kërkuar, ai humbet të drejtën që dosja e tij të shqyrtohet në vijim për të përfituar grantin e rikonstruksionit.
- Njësia administrative/lagjia gjatë procesit të plotësimit të dokumentacionit për çdo aplikim që është paraqitur pranë njësisë përkatëse, duhet të evidentojnë të gjitha aplikimet e bëra më shumë se njëherë për të njëjtën banesë të dëmtuar.
- Nëse Njësia Administrative/Lagja identifikon më shumë se një aplikim për të njëjtën banesë të dëmtuar, njofton palët aplikuese se do të konsiderohet si i vlefshëm vetëm një prej aplikimeve, sipas dakordësisë së arritur mes aplikantëve duke nënshkruar deklaratën tip sipas aneksit nr.2, bashkëlidhur këtij udhëzuesi. Në rast se nuk kemi dakordesi midis aplikuesve, do të vijohet me procedurat përkatëse deri në fazën para nënshkrimit të kontratës për përfitimin nga grandit i rindërtimit, ku aplikuesit duhet të paraqesin dakordesine e arritur midis tyre.
- Njësitë administrative përpara se të ripërcjellin dosjet pranë DRSHS, duhet të:
 - a) Kryejnë verifikimet për çdo aplikant si edhe për çdo anëtar tjetër të familjes që është pjesë e certifikatës familjare, nëse ka në pronësi ose posedim të ligjshëm, më shumë se një banesë, në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, nëpërmjet llogarisë së krijuar në sistemin digjital të përcjellë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.
 - b) Nëse pas verifikimit në sistem konstatohet se individit/ familja ka në pronësi ose posedim të ligjshëm, më shumë se një banesë, në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, ky dokumentacion do të shkarkohet nga sistemi digjital dhe do të bashkëlidhet dosjes së aplikantit. Kjo praktikë do të administrohet nga vetë njësia administrative/lagjia duke njoftuar subjektin aplikues se nuk plotëson kushtet dhe kriteret që rregullojnë procedurat për përfitimin nga programet e procesit të rindërtimit.
- 7. Njësitë Administrative/Lagjet përkatëse i përcjellin Drejtorisë së Rindërtimit të Shërbimeve Sociale, vërtetim ose dokumentacion, që vërteton aplikantët prioritarë gjatë fazës së dytë, sipas sistemit të pikëzimit. Kjo vlen në rastin kur aplikuesi ka lëshuar deklaratën sipas shtojcës "ç", të VKM nr. 904/2019. Dokumentacioni sigurohet nga Njësia Administrative ose nga personat përgjegjës të autorizuar. Në rastin kur aplikuesi nuk ka dhënë pëlqimin për nxjerrjen e dokumentacionit, sigurimi i tyre do të realizohet nga vetë aplikuesi, duke bërë plotësim dokumentacioni pranë Njësisë Administrative/ Drejtorisë së Informimit dhe Shërbimeve me qytetarët, pas Njoftimit Publik.

Përpara se dosjet e plotësuara të përcillen pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Rindërtimit të Shërbimeve Sociale, së bashku me grupet e punës të ngritura pranë këtyre njësive do të asistojnë dhe ndjekin fazën e dytë të këtij procesi si vijon:

- a). Të riverifikojnë për çdo aplikant si edhe çdo pjesëtar tjetër të përfshirë në certifikatën familjare, ku ka dyshime ose mospërputhje dokumentacioni nëse ka në pronësi ose posedim të ligjshëm, më shumë se një banesë, në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, nëpërmjet llogarisë së krijuar në sistemin digjital të përcjellë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.
- b). Nëse pas verifikimit në sistem konstatohet se individ/ familja ka në pronësi ose posedim të ligjshëm, më shumë se një banesë, në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, ky dokumentacion do të shkarkohet nga sistemi digjital dhe do të bashkëlidhet dosjes së aplikantit.
- c). Nëse në sistemin digjital të vendosur në dispozicion nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk liquron asnjë pronë tjetër e paluajtshme e regjistruar e individit/familjes përveç asaj të deklaruar si të dëmtuar në aplikim, Njësia Administrative/Lagjet i kërkojnë aplikantit nënshkrimin e vetëdeklarimit mbi pasuritë e paluajtshme, bashkëlidhur këtij udhëzuesi, aneksi nr. 1.
- ç). Pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar sipas parashikimeve të lartpërmendura Njësia Administrative/lagjia përkatëse përcjell dosjet pranë, duke iu bashkëlidhur një informacion të përgjithshëm për të gjitha aplikimet që përcjell nëpërmjet shkresës përkatëse.

8.Strukturat përgjegjëse

8.1 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social, Drejtoria e Rindërtimit, në bazë të urdhrit të Kryetarit

Në vijim, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Rindërtimit të Shërbimeve Sociale do t'i vendosë ato në dispozicion të Sekretariatit teknik:

Dosjet e aplikimeve

Listën e Përfitueseve që kanë përfitur grante në tërmetin e shtatorit.

Listën e Përfituesve që kanë përfitur banesë nga donatorët .

Vlerëson cilat janë familjet prioritare në bazë të sitemit të pikëzimit.

Listën e fituesve të trajtuar për bonus qeraje, nga tërmeti i datës 26.11.2019.

8.2 Sekretariati Teknik, si strukturë e posaçme do të përmbushë këto detyra:

1. Kontrollin e dosjeve të çdo aplikanti sipas dokumentacionit që vërteton deklaratimet e bëra në momentin e aplikimit.
2. Sigurimin dhe mbledhjen e dokumentacionit të kërkuar për çdo aplikant, i cili ka depozituar deklaratën e pëlqimit për këtë qëllim.
3. Dhënie e mendimit kur i kërkohet nga komisioni, mendim i cili pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes;
4. Mban, harton dhe nënshkrimin e procesverbalit të mbledhjes;
5. Zbardh vendimin e arsyetuar të marrë në mbledhjen e Komisionit;
6. Ruan konfidencialitetin;

7. Përbush detyra të tjera që mund t'i ngarkohen nga komisioni posaçëm.

8.3 Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve përfituese nga programi i grantit të rindërtimit:

Komisioni, në cilësinë e kryetarit drejtohet nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale, dhe ka në përbërje në cilësinë e anëtarëve përfaqësues si më poshtë:

- a. Përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësiave Administrative dhe Emergjencave Civile;
- b. Përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;
- c. Përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, të Aseteve dhe Licencimit;
- d. Përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar.

Komisioni i posaçëm:

- a. Do të përbushë detyrat e përcaktuara në vendimin nr. 904, datë 24.12.2019, vendimin nr. 5, datë 6.1.2020 të Këshillit të Ministrave, si dhe çdo detyrë tjetër që i ngarkohet sipas legjislacionit në fuqi.
- b. Vlerëson kërkesat e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të vendimeve të Këshillit të Ministrave si dhe harton listën e subjekteve përfitues/jopërfitues të programit të rindërtimit pranë Kryetarit të Bashkisë.
- c. Komisioni i Posaçëm i paraqet kryetarit të Bashkisë raportin e plotë me propozimin për subjektet përfituese dhe ata që nuk plotësojnë kriteret për përfitim.

8.4 Kryetari i Bashkisë:

Kryetari vendos brenda 10 (dhjetë) ditëve pune për listën e fituesve.

8.5 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Rindërtimit merr të gjitha masat e nevojshme që nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme e Marrëdhënieve me Publikun dhe Jashtë të njoftojë aplikuesit që përfitojnë nga programi i rindërtimit dhe ato që nuk përfitojnë. Individët/familjet që pretendojnë se vlerësimi i shkallës së dëmtimeve nuk përputhet me dëmin real të shkaktuar në banesat e tyre, si dhe aplikantët që nuk rezultojnë përfitues nga ky nënprogram, kanë të drejtën e ankimit pranë

8.6 Subjektet jo fituese mund të paraqesin ankesat e tyre në Bashkinë Tiranë brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, pranë zyrës së Nënkrëtares, zonjës Anisa Ruseti.

Pas përfundimit të afatit/shqyrtimit të ankesave dhe pas marrjes së të dhënave në lidhje me subjektet ankimese, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit ndjekin procesin e hartimit të projektvendimit për miratimin e listës së subjekteve përfituese, për t'ia paraqitur për shqyrtim dhe miratim Këshillit Bashkiak.

8.7 Këshilli Bashkiak miraton listen për aplikantët fitues për rindërtimin e banesave / Lagjet e reja për individët ose familjet përfituese.

Pas hyrjes në fuqi të vendimit përkatës të Këshillit Bashkiak, Drejtoria e Përgjithshme e Marrëdhënieve me Publikun dhe Jashtë shpall listën e përfituesve në stendën e buletineve për publikun, faqen e internetit të Bashkisë dhe/ose në vende të tjera publike. Ky proces, më pas finalizohet me lidhjen e kontratës, formati tip i së cilës është bashkëlidhur VKM 904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit".

8.8 Kontrata- për kalimin e banesave/shtëpive individuale në pronësi të përfituesve duhet të shoqërohet me deklaratën noteriale të heqjes dorë nga subjektet përfituese nga çdo pretendim mbi të drejtat e pronësisë për banesën apo shtëpinë individuale të mëparshme, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në vendimin 904/2019 ose në aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", si kusht për përfitimin nga programet e procesit të rindërtimit

1. Në rastin e ndërtimit të banesave të reja, kushtet, kriteret për përfilimin dhe afatet përkatëse përcaktohen në kontratën që nënshkruhet nga Bashkia Tiranë dhe subjekti përfitues.

ANEKSI NR. 1

VETËDEKLARIM MBI PASURITË E PALUAJTSHME

Unë i nënshkruari.....(Emri Atësia Mbiemri), me numër identifikimi personal sipas Letërnjoftimit, i lindur më (datë/muaj/vit), në qytetin/fshatin e, banues në (adresa e deklaruesit), deklaroj me vullnet të lirë nën përgjegjësinë time të plotë ligjore se përveç pronës së deklaruar në këtë aplikim, unë ose anëtarët e familjes time sipas certifikatës familjare:

nuk kam/nuk kemi

kam/kemi

të drejta pronësie / bashkëpronësie apo posedimi të ligjshëm mbi pasuri të tjera të paluajtshme me funksion banimi, në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, të cilat vërtetohen me një prej mënyrave si më poshtë:

| | | | |
|---|--|--|---|
| <input type="checkbox"/> Certifikatë Pronësie | <input type="checkbox"/> Listë Trojesh | <input type="checkbox"/> Kontratë Porosie/ Sipërmarrje | <input type="checkbox"/> Vërtetim Karabinaje (+ leje ndërtimi) |
| <input type="checkbox"/> Vërtetim Hipotekor | <input type="checkbox"/> Leje Legalizimi | <input type="checkbox"/> Leje Ndërtimi | <input type="checkbox"/> Kontratë Shkëmbimi |
| <input type="checkbox"/> Kartelë e Pasursurisë | <input type="checkbox"/> Leje Ndërtimi | <input type="checkbox"/> Vërtetim Fakti (94') | <input type="checkbox"/> Akt-Marrëveshje |
| <input type="checkbox"/> Vërtetim Legalizimi | <input type="checkbox"/> Kontratë Privatizimi | <input type="checkbox"/> Vërtetim i Komisionit për Kthim dhe Kompesim | <input type="checkbox"/> Të tjera (Specifiko) |
| <input type="checkbox"/> Aplikim sipas VKM 442 | <input type="checkbox"/> Kontratë Shitje | <input type="checkbox"/> Vendim Gjyqësor | |

Të sqarohen informacionet shitesë mbi pasuritë e paluajtshme të fituara me një prej mënyrave të mësipërme, (lloji/ adresa/bashkëpronarë nëse ka):

- I gjithë informacioni i deklaruar në këtë deklaratë është i vërtetë dhe jam në dijeni se për çdo informacion të rremë, mua ose anëtarëve të familjes time iu hiqet e drejta për të përfituar nga programi i granteve të rindërtimit.
- Deklaroj nën përgjegjësinë time personale se unë ose familja ime nuk kam/nuk kemi përfituar nga ndonjë program tjetër i procesit të rindërtimit.

- Jam i vetëdijshëm se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i kësaj deklaratë mund të pasjellë fillimin e procedurave për pergjegjesine civile dhe penale sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
- Pranoj që, në rast se përzgjidhem për t'u trajtuar nga programet e procesit të rindërtimit, të bëhet verifikimi i të gjithë informacionit të dhënë nga Njësia e Vetëqeverisjes Vendore.

Data .. / .. / ..

(Emër Mbiemër, Firma)

Kontrata Tip e kontratave të rindërtimit XXX.

Shtojca C

Vërtetim që Konfirmon Regjistrimin e Kërkesës, Objektin e saj, Datën dhe Listën e Dokumenteve të Bashkëlidhura

Nr. ___ Prot. _____, më ____/ ____ 202....

Lënda: Vërtetim regjistrimi kërkesë për t'u trajtuar nga programet e procesit të rindërtimit.

Drejtuar: Z./Znj. _____
(adresa)

I nderuar Z./Znj. _____,

Vërtetojmë se ju keni paraqitur kërkesën me nr. _____ protokoli, datë _____, e cila

është regjistruar pa të meta pranë _____ (njësia e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore), me anë të së cilës paraqisni preferencën tuaj për t'u trajtuar nga programet e procesit të rindërtimit.

Kërkesa juaj është regjistruar me nr. _____ në regjistrin elektronik të sistemit të pikëzimit.

Bashkëlidhur kësaj kërkesë janë depozituar edhe dokumentet, si më vijon:

Titulli i dokumentit

Nr. i faqeve

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

(emri i punonjësit,
firma)

Shtojca Ç

Deklaratë për dhënien e Pëlqimit Për Lejen Për Marrjen e Dokumentacionit Për Fazën e Dytë të Aplikimit.

Deklaratë

Për Dhënjen e Pëlqimit Për Mbledhjen e Të Dhënave, Aneksin Për Njohjen dhe Administrimin e të Dhënave Personale

Unë _____, i biri i/e bija e _____ dhe i/e _____
lindur më _____, në _____, dhe banues/banuese në
_____, me shtetësi _____, me
identifikimi _____, me vullnetin tim të lirë,

DEKLAROJ SE:

Mbështetur dhe në zbatim të:

- Vendimi nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave, "Përcaktimin e rregullave, kategorive prioritare, masën e përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin e përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit";
- Akti normativ nr. 9, datë 16.12. 2019, të Këshillit të Ministrave "për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore";
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar.

Deklarim

Firma(në kutinë që aplikanti dëshiron të plotësojë)

Jap pëlqimin që të mblidhen të dhënat e nevojshme, sipas parashikimeve të pikës ___, të vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave.

Jap pëlqimin që të mblidhen të dhënat dhe të kryhen procedurat e verifikimit të këtyre të dhënave.

Jam dakord që të dhënat e mia personale të mbledhura në referim të pikës ___, të vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave, të trajtohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, për trajtimin e kërkesës sime për t'u trajtuar me programet e procesit të rindërtimit, të parashikuara ne aktin normative nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e pasojave të Fatkeqsive natyrore".

Nuk jap pëlqimin që të mbliidhen të dhënat e nevojshme, sipas parashikimeve të pikës __, të vendimit nr. __, datë __, të Këshillit të Ministrave.

Nuk jap pëlqimin që të mbliidhen të dhënat dhe të kryhen procedurat e verifikimit të këtyre të dhënave.

Nuk jam dakord që të dhënat e mia personale të mbledhura në referim të pikës __, të vendimit nr. __, datë __, të Këshillit të Ministrave, të trajtohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, për trajtimin e kërkesës sime për t'u trajtuar me programet e procesit të rindërtimit, të parashikuara ne aktin normative nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e pasojave të Fatkeqësive natyrore".

____, më ____ 2020
DEKLARUESI

()



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 65, datë 19.04.2021

**“PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE TË NËNPROGRAMIT TË GRANTIT TË
RIKONSTRUKSIONIT, BANESAT E TË CILËVE JANË KLASIFIKUAR NGA
AKTEKSPERTIZAT E THELLUARA TË INSITUTIT TË NDËRTIMIT ME NIVEL DËMI DS4”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, vendimit nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, vendimit nr. 5, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, të ndryshuar, pikës 2, të vendimit nr. 160, datë 7.12.2020, të Këshillit Bashkiak “Për përcaktimin e vlerave për përfituesit e grantit të rikonstruksionit/rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga aktekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmsh DS4 dhe DS5” të ndryshuar, urdhrin nr. 11408/1, datë 25.03.2020, të kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve përfituese nga programi i grantit të rindërtimit”, të ndryshuar, si dhe në vijim të Raportit të Komisionit të Posaçëm, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e raportit të komisionit të posaçëm për aplikimet e kryera për të përfituar nga nënprogrami i grantit të rikonstruksionit, për banesat e klasifikuara nga aktekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmi DS4.
2. Miratimin e listës të subjekteve përfituese nga nënprogrami i grantit të rikonstruksionit, pjesë e programit të rindërtimit, sipas aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Subjektet përfituese të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, përfitojnë vlerën e rikonstruksionit sipas parashikimeve të vendimit nr. 160, datë 7.12.2020, të Këshillit Bashkiak “Për përcaktimin e vlerave për përfituesit e grantit të rikonstruksionit/rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga aktekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmsh DS4 dhe DS5”, të ndryshuar.
4. Vlera përkatëse financiare e grantit të rikonstruksionit për secilin përfitues, të përcaktohet nga njësitë administrative/lagjet e Bashkisë Tiranë, në bazë të planimetrisë së dorëzuar nga përfituesit, e cila hartohet nga projektues të licencuar dhe i bashkëlidhet kontratës përkatëse, ku identifikohet qartë struktura e banesës së dëmtuar, përkatësisht 1+1; 2+1 dhe 3+1 ose më shumë.
5. Bashkia Tiranë ngarkohet të korrigjojë gabimet në rast se evidentohen në listat e përfituesve të përcaktuar në këtë vendim, si dhe në aktet e tjera të Këshillit Bashkiak që kanë për objekt shpalljen e listave fituese nga nënprogrami i grantit të rikonstruksionit. Korrigjimet i paraqiten Këshillit Bashkiak për miratim.
6. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga fondet e rindërtimit të transferuara nga Këshilli i Ministrave në buxhetin e Bashkisë Tiranë.

7. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Njësitë Administrative dhe Lagjet e Bashkisë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

KRYETAR

ROMINA KUKO

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Romina Kuko', is written over a circular official stamp. The stamp is light blue and contains the text 'BASHKIA E TIRANES' at the top and 'MUNICIPALITY OF TIRANA' at the bottom. The signature is written in a cursive style and extends across the stamp.

| Nr | Njësia | Emër | Atesla | Mbiemer | ID |
|-------------------------------------|----------|----------|----------|---------|------------|
| 1 | Baldushk | Puço | Rustem | Beti | 030119041H |
| 2 | Kashar | Asllan | Demush | Balaj | G30623095P |
| 3 | Nja 3 | Marigo | Thoma | Kazazi | D76214031M |
| 4 | Nja 3 | Vladimir | Riza | Lika | H51214040D |
| 5 | Nja 8 | Arben | Sulejman | Gjoka | G50316154M |
| 6 | Vaqarr | Besnik | Shefqet | Hyka | G50324157L |
| Ankimime nga organi ankimore | | | | | |
| 1 | Ndroq | Enver | | Mansaku | G70528146U |

